



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:097702

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06186984

KPPP.nr. 584/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “3P” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810842303 dhe seli në Prishtinë, rr. “Ahmet Krasniqi”, p.n., kundër debitorit “Automatics-Ks” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811186560 dhe seli Prishtinë, rr. “Abdullah Tahiri”, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 147/24 të datës 21.02.2024, të lejuar nga Përmbartues Privat Isa Gacaferi nga Prishtina, jashtë seancës me datën 20.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Automatics-Ks” Sh.P.K., ndërsa Urdhri përmbartimor P.nr. 147/24 të datës 21.02.2024, të lejuar nga Përmbartues Privat Isa Gacaferi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “3P” Sh.P.K., ka caktuar urdhrin P.nr. 147/24, të datës 21.02.2024, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr. INV/2022/69744, e datës 12.12.2022; Faturës nr. INV/2023/2996, e datës 25.01.2023; Faturës nr. INV/2023/6464, e datës 15.02.2023; Faturës nr. INV/2023/9747, e datës 13.03.2023; Faturës nr. INV/2023/10146, e datës 14.03.2023; Faturës nr. INV/2023/11406, e datës 22.03.2023; Faturës nr. INV/2023/14540, e datës 13.04.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 3,663.00 EUR, me kamatë ligjore duke llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se faturat në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbarimore nuk i plotësojnë kushtet ligjore, sepse të njëjtat nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori. Ka shtuar se kohë pas kohe kanë bërë pagesa, andaj edhe borxhi i kërkuar nga kreditori nuk është i saktë. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditore në përgjigjen në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar duke theksuar se qëllimi i debitorit është shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit, pasi që prapësimi nuk mbështetet në asnjë nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Më tej, ka theksuar se nga komunikimet në mes të palëve, debitori nuk ka e kontestuar vlerën e borxhit dhe pranimin e faturave, ashtu që urdhri përmbarimor është lejuar në përputhje me dispozitat ligjore, përkatësisht me nenin 21, 29, 37 dhe 38 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet : Fatura nr. INV/2022/69744, e datës 12.12.2022; Fatura nr. INV/2023/2996, e datës 25.01.2023; Fatura nr. INV/2023/6464, e datës 15.02.2023; Fatura nr. INV/2023/9747, e datës 13.03.2023; Fatura nr. INV/2023/10146, e datës 14.03.2023; Fatura nr. INV/2023/11406, e datës 22.03.2023; Fatura nr. INV/2023/14540, e datës 13.04.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë

treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në anën tjetër, përkundër faktit se dokumentet e besueshme të lartpërmendura nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit tek pranuesi i faturës, gjykata, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se debitori ka qenë i njoftuar lidhur me faturat dhe detyrimin që dervion nga to, e të cilin detyrim asnjëherë nuk e ka kundërshtuar. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që kreditori, me propozimin për përmbarim, ka bashkangjitur si dëshmi komunikimet elektronike nga të cilat shihet që secila faturë objekt i këtij përmbarimi, i është dërguar debitorit në adresën elektronike të tij, me njoftimin që në rast se ekziston ndonjë paqartësi apo ankesë lidhur me faturimin, të paraqitet kundërshtim në afatin prej pesë (5) ditëve. Ndërsa, përkundër faktit që debitori, nuk ka bërë konfirmimin e pranimit të faturave përmes adresës elektronike, nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se debitori, përmes adresës elektronike në të cilën i janë dërguar faturat nga kreditori, me datë 06.03.2024 ka dorëzuar prapësimin pranë përmbaruesit privat.

Nga këto të gjetura, gjykata vërtetoi faktin se adresa elektronike në të cilën kreditori i ka dërguar faturat për debitorin, është pikërisht adresa të cilën debitori e posedon dhe e ka në shfrytëzim meqenëse nga kjo adresë, debitori ka komunikuar me Përmbaruesin Privat duke e dorëzuar prapësimin ndaj urdhrit përmbarimor. Andaj, mungesa e konfirmimit të pranimit të faturave të dorëzuara në adresën e lartcekur elektronike, në rastin konkret, nuk i bën faturat objekt i këtij përmbarimi si të papërshtatshme për përmbarim pasi që debitori, ka pasur mundësi që të bëjë kundërshtimin e faturave përmes kësaj adrese elektronike por që i njëjti, faturat rezulton se i ka pranuar me rregull ndërsa nuk ka paraqitur asnjëherë vërejtje për to.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 584/24, datë 20.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.